



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar / Prijmljeno/Prodato Received/Delivroy	17 - 11 2022	2 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SP/MSH/CK	7203/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.870/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmati-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.870/2022 të datës 06.10.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson kundër Vendimit me numër protokolli 184/22 të datës 22.09.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa me numër A.nr.870/2022 e datës 06.10.2022 e parashtruar nga ankuesi *si e bazuar.*
- II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 184/22 i datës 22.09.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe vendosje të organi kompetent.
- III. Obligohet Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikë II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, përmes përfaqësuesit të tij me autozim, me datë 06.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5921/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli

184/22 të datës 22.09.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Shërbyesit Civil si dhe Kodin e Procedurës Penale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.10.2022 proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Qendrore të Prokurimit. Ndërsa Këshilli, me datë 13.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5921/2022 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.09.2022; Zarfën e datës 04.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 13.10.2022; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt të Emërimit i datës 08.07.2019 për ankuesin dhe Vendimin me numër protokollit 184/22 të datës 22.09.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që janë plotësuar kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 08.07.2019 është i punësuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit në pozitën e punës "Shef i Sektorit për Prokurim".

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit më datë 22.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 184/22 për largim të ankuesit nga puna pasi që i njëjti me vendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë është shpall fajtor dhe ka pranuar fajin për kryerje të veprës penale. Kundër këtij vendimi, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Shërbyesit Civil si dhe Kodin e Procedurës Penale, duke theksuar se organi i punësuar nuk ka pranuar asnjë aktgjykim nga gjykata kompetent sepse edhe vet vendimi atakuar nuk i referohet aktgjykimit me numër dhe datë, dhe së më largimin e tij nga punë është shkel parimi i prezumimit të fajësisë sepse ankuesi ka të drejtën e ankesës ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Propozon që Këshilli ta anuloj vendimin e goditur me ankesë si të kundërligjshëm.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil përkatësisht:

Nenit 59 më të cilin është përcaktuar se: 1. *Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon, si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirimin nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj.*

Nenit 60 më të cilin parashihet se: *Përfundimi në rastet e përcaktuara nga ligji 1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.1. nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 1.2. nëpunësi humb shtetësinë apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.3. plotësohet moshja për pensionim; 1.4. konstatohet*



paovlefshmëria e aktit të emërimit; 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër.... 4.Përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, për shkak të ligjit, konstatohet jo më vonë se brenda 5 ditëve nga ndodhja apo njohja e shkakut të përfundimit, 4.1. Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën; 4.2. ministria përgjegjëse për administratën publike, për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore.

Andaj, bazuar në dispozita ligjore si me sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar vendimin e kundërshtuara më ankesë dhe si rrjedhojë ka gjetur se arsyetimi i vendimit është i mangët dhe i pamjaftueshëm përkatësisht arsyetimi nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret. Andaj, një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Rrjedhimisht Kolegji duke u bazuar në nenin 60 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: .. 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër,* konstatoi se përfundimi i marrëdhënies së punës së nëpunësit civil mund të bëhet vetëm në rast se me vendim gjyqësor të formës së prerë është vërtetuar se nëpunësi civil ka kryer vepër penale me dashje apo që i njëjti më vendim të formës së prerë gjyqësor është dënuar me burgim efektiv me shumë se tre muaj, ndërsa në rastin e ankuesit organi punëdhënës bazohet në një aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë pa numër dhe datë të lëshimit, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë vendim gjyqësor i formës së prerë në lidhje më vepren penale siç pretendohet në vendimin e kundërshtuar, kështu që mbi këtë bazë pretendimi ankimor është i drejtë.

Me tutje, Kolegji vlerëson së dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe dënimi më vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër, përbejnë shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, mirëpo vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës në rastet e tilla lëshohet nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, ashtu siç përcaktohet me nenin 60 paragrafi 4 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e mbi këtë bazë ligjore rrezulton së Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Qendrore të Prokurimit nuk ka pas kompetencë lëndore për nxjerrjen e Vendimit me numër protokollit 184/22 të datës 22.09.2022 me të cilin ankuesi e ka larguar nga puna.

Për me tepër, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se si bazë ligjore për nxjerrjen e vendimit të kundërshtuar me ankesë janë listuar dispozitat ligjore të nenit 46 paragrafi 3, nenit 47 paragrafi 1.4, nenin 50, nenit 56 dhe nenit 73 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson së në rastin konkret gabimisht janë përcaktuar referencat ligjore për nxjerrjen e vendimit sepse dispozitat e nenit 46, 47, dhe 56 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë rregullojnë çështjet e disiplinës së nëpunësve civil, neni 56 ka të bëjë më pezullimin e nëpunësve civil sipas detyrës zyrtare, ndërsa neni 73 i referohet ndërprerjes së kontratës së punës të nëpunësve të shërbimit publikë. Ndërlidhur me këtë edhe arsyetimi i vendimit është në kundërshtim të plotë me dispozitivin sepse largimi nga shërbimi civil mund të bëhet vetëm për shkak të masës disiplinore " *Largim nga shërbimi civil*" për shqiptimin e të cilës masë është kompetente vetëm



Komisioni Disiplinor siç është përcaktuar me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, duke qenë se Vendimi i atakuar me numër protokoli 184/22 i datës 22.09.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen e ankuesit dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.870/2022

Ilire Mehmeti SHAQIRI

Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesi Avokat
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Qendrore të Prokurimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Qendrore të Prokurimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.